



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 103, datë 31.08.2021

PËR

MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M², E NDODHUR NË KATIN E PARË TË SHKOLLËS “JAN KUKUZELI”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 1 VIT, ME TË DREJTË RIPËRTËRITJE, PËR T’U PËRDORUR PËR ADMINISTRATËN E KËSAJ DREJTORIE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkresës nr. 300/2 prot., datë 24.06.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, administruar nga Bashkia me nr. 7684 prot., datë 28.06.2021, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Komuniteteve Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambjentit me sipërfaqe ndërtimi 199 m² dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhurur në katin e parë të shkollës “Jan Kukuzeli”, pronë e

Bashkisë Durrës, për një afat kohor 1 vit, me të drejtë ripërtëritje, për t'u përdorur për administratën e kësaj Drejtorie.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 31.08.2021

PLANIMETRIA E KATIT PARE TE AMBIENTIT DHE SIPERFAQES TE DESTINUAR PER QERADHENIE TE SHKOLLES JAN KUKUZELI



SIPERFAQJA E DESTINUAR PER QERADHENIE
SIPERFAQE NDERTIMI 199m²
SIPERFAQE FUNKSIONALE. 21,4m²

PLAN - VENDOSJA E OBJEKTIT
sh 1/1000




POZICIONIMI I SIPERFAQES PER QERADHENIE
kati pare

PËRGATITI
 Sektori i Aesteteve
 Specialiste: A.HUKUJA
 Shefe e Sektorit të Aesteteve
 I. Bushi

Drejtori Lajçare:
 A. Jeta

IDENTIFIKIMI I PASURIS
 ZONA KADASTRALE B514
 Nr i pasurisë 46/41
 Indeksi i Hartes
 Adresa e Pasurisë : Durrës
 Pronesia: Bashkia Durrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 671/16 prot.

Durrës, më 07 . 09 . 2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.103 datë 31.08.2021 “Për miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshpërbllim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambientit me sipërfaqe ndërtimi 199 m² dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhur në katin e parë të shkollës “Jan Kukuzeli”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 1 vit, me të drejtë ripërtëritje, për t’u përdorur për administratën e kësaj drejtorie

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

